



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

**Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve
“Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”**

Neni 1

Shpërblimi **“Emblema e artë”** i ndahet, **Avdi R. BERISHA** nga Suhareka (postmortum).

Neni 2

Shpërblimi **“Skënderbeu”** i ndahet: **Muhamet Rr. KRASNIQI** nga fshati Peqan Komuna e Suharekës (dëshmorë).

Neni 3

Mirënjohja **“13 Qershori”** i ndahet këtyre të nominuarëve: **1. Kurtesh M. FONDAJ** nga fshati Peqan, **2. Nysret S. Samadraxha** nga fshati Samadrexhë, **3. Mehdi efendi HOXHA** nga fshati Bllacë (postmortum), **4. Themeluesve të “Brigadës 123” të UÇK-së Zona Operative e Pashtrakut, Blerim KUÇI, Habib ELSHANI, Agim KUÇI, Ilaz KADOLLI, Isuf KRASNIQI dhe Ruzhdi GASHI.**

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI